



Jezusi historik dhe Krishti i besimit

## Description





## Geza Vermes

Në fund të shekullit të parë të erës sonë, Krishterimi kishte humbur nga vëmendja e tij Jezusin e vërtetë dhe kuptimin fillestarë të mesazhit të tij. Pali, Gjoni dhe kishat e tyre, e zëvendësuan Jezusin historik me Krishtin hyjnor të besimit, ndërsa këmbënguljen e tij mbi përpjekjen personale, përqendrimin dhe mbështetjen tek Zoti, e zëvendësuan me meritat shpëtuese të një shëlbyesi të përhershëm dhe hyjnor. Shpejtësia e këtij devijimi të Krishterimit ndodhi falë ndryshimit të parakohshëm në këndvështrimin kulturor. Disa dekada pas vdekjes së Jezusit, mesazhi i tij i vërtetë u shpërngul nga konteksti gjuhësor semit (Aramaik/Hebre), mjedisi gjeografik galileas/palestinez dhe sistemi religjioz hebraik, drejt një mjedisi të huaj për të. Mefjalë të tjera, emigrimi i lëvizjes së Jezusit nga territori natyror hebraik drejt mjedisit kulturor klasik të botës pagane mesdhetare, kryesisht greqishtfolëse, ndodhi në një periudhë shumë të hershme. Qëllimet, idetë dhe stili i jetës së Krishterimit nuk pati kohën e duhur për tu zhvilluar dhe kristalizuar. Argjila ishte e butë dhe e lakueshme, ajo mundej ende të modelohej në çdo lloj forme që dëshironte ti jepte asaj poçari. Si rrjedhojë, kishat e reja, e cila në atë kohë përbëhej kryesisht nga xhentilë, e humbi shumë shpejt ndërgjegjen e të qenurit hebraike, madje ajo në mënyrë progresive u bë anti-hebraike.

Një tjetër kthesë në Krishterim shfaqti një efekt të pafavorshëm mbi joshjen e mesazhit të krishterë tek hebrenjtë e Palestinës dhe të diasporës. Jezusi, njeriu religjioz i pajisur me një joshje të parrezistueshme karizmatike, u transformua (nga Kisha e hershme) në Jezun Krishtin, objektin transcendent të religjionit të krishterë. Profeti i largët, por i zjarrtë, nga Nazareti i cili shpallte afërsinë e mbërritjes së Mbretërisë së Perëndisë nuk ishte shumë tërheqës për të sapokonvertuarin, me nivel mesatar, në Krishterim i cili vinte nga Aleksandria, Efesi, Korinti apo Roma. Vështrimi i tyre ishte i drejtuar drejt një shpëtimtari universal, madje edhe drejt Fjalës së përhershme dhe të Mishëruar të Perëndisë, i cili në të njëjtën kohë ishte edhe vetë Perëndi. Kështu që, duke nisur që nga shekulli idytë i erës sonë, Kisha gjithnjë e më rritje e krishterë, e udhëzuar nga mendje të shquara e të stërvitura në filozofinë greke, të tillë si Ireneusi i Lionit, Klementi, Origjeni dhe Athanasi i Aleksandrisë, e zëvendësuan manifestin ekzistencial religjioz të Jezusit të vërtetë, i cili përkrahte pendimin, gatishmërinë e menjëhershme dhe nënshkrimin ndaj Zotit, me një program të rrënjësor në spekulimin metafizik rreth personit dhe natyrës së Krishtit të mishëruar, marrëdhënies së tij me Birin epërhershëm të Perëndisë si edhe lidhjet e ndërsjella midis personave hyjnorë të Trinitës së shenjtë. Shkrimet e shenjta, përfshi edhe Dhjatën e Vjetër, u shqyrtuan imtësisht për të gjetur citime të përshtatshme (për doktrinën) dhe u interpretuan në mënyrë alegorike me synimin që të provoheshin përfundimet e arritura përmes arsyesimit filozofik. Kjo procedurë u bë më e lehtë, për këta mendimtarë të mëdhenj helenist, nga fakti se si Dhjata e Vjetër ashtu edhe ajo e reja ishin në gjuhën greke, me të cilën ato ishin të familjarizuara dhe të cilën mund ta manipulonin lehtësisht. Dhe ata mund tash të mbëronin atë lirisht, për shkak se në atë kohë, në Krishterim, nuk ekzistonte asnjë zë hebraik që potencialisht mund të vinte alarmin.

Natyrisht që as më shkon ndërmend që ti mohoj Krishterimit legjitimitetin teorik të misionit të Kishës primitive në botën xhentile. Nëse krishterimi nuk do të ishte rrënjësor në provincat e perandorisë Romake, atëherë ai do kishte mbetur thjesht një sekt i vogël hebraik me një joshje të jashtme jo më të madhe se ajo e prozelitizimit të zakonshëm hebraik të kryer në lashtësinë e vonshme. Madje, mund të argumentohet se, ndonëse Jezusi historik nuk ka pasur asnjë qëllim që të drejtohej xhentilëve, gjithsesi thelbi i mesazhit të tij përmbante një element të nënkuptuar universalisht. Kështu që, në momentin kur Kisha vendosi se edhe johebrenjtë mund të pranoheshin në gjirin e saj, pa qenë nevoja që ata të detyroheshin, së pari, që të përqafonin mënyrën e jetesës hebraike, ishte e logjikshme që të tentohej një "përkthim" i kuptimit të mesazhit të krishterë për dobi të botës xhentile. Kjo çështje, e quajtur inkulturim\*, në ditët tona është bërë subjekt i debateve të nxehta në kontinentin Evropian.

---

Ky shkëmbim i ndërsjellët është pothuajse një pjesë e domosdoshme e çdo evolucioni kulturor, por ai është i vlefshëm dhe i pranueshëm vetëm nëse nuk të dërgon në shtrembërime thelbësore. Nëse procesi i përshtatjes së mesazhit të Jezusit do të kishte qenë në duart e përfaqësuesve të kulturës së

**Date Created**

05/10/2014

**Author**

erasmusi